



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni vjeshtor**

Kryesia e Kuvendit  
MK-78  
Prishtinë, më 22 shtator 2009, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 22 SHTATOR 2009

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi, Nexhat Daci, Naim Maloku, Sllobodan Petroviq dhe Mufera Sinik, kurse mungoi Xhavit Haliti.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Lutfi Haziri, Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli, Ardian Gjini dhe Xhezair Murati, kurse mungoi Bojan Stojanoviç.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Skënder Reçica dhe Eshref Vishi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Naim Abazi, dhe Sherif Konjufca;

Nga NDI: Shefki Kastrati dhe

Nga OSBE: Petrit Hysaj.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

### **R e n d i t e:**

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 8 shtator 2009,
2. Propozimi i rendi te ditës për seancën e ardhshme plenare,
3. Shqyrtimi i mocioneve dhe i kërkesave,
4. Të ndryshme.

#### **1. Miratimi Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, më 8 shtator 2009**

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 8 shtator 2009, u miratua pa vërejtje.

#### **2. Propozimi i rendi te ditës për seancën e ardhshme plenare**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pik veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, **v e n d o s i** që seanca e ardhshme e Kuvendit të mbahet më 30 shtator 2009, në orën 10:00, me këtë

### **R e n d i t e**

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare, të mbajtur më 17 shtator 2009,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për standardizimin,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për gazin natyror,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë,
6. Shqyrtimi i Propozimit për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës,
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Kosovës për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave,
8. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për transferin e mjeteve buxhetore në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,
9. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për lejimin e numrit të punëtorëve në ekipet përgatitore komunale,
10. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për korrigjimin e numrit të punëtorëve në Autoritetin e Aviacionit Civil,
11. Shqyrtimi i Raportit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2008,
12. Shqyrtimi i Projekt-strategjisë kundër korrupsionit për periudhën 2009-2011 dhe
13. Debat për gjendjen tregtare në vend dhe raportet tregtare të Kosovës me shtetet e tjera, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDD-së.

Në ndërkohë, me kërkesë të Kryetarit, lidhur me pikën e shtatë u nxjerr ky

## **P Ë R F U N D I M**

Udhëzohet Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media që të bëjë konsultime shtesë me Qeverinë e Kosovës, përkatësisht me Ministrinë e Administratës Publike për të harmonizuar datën e fillimit të regjistrimit të popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave, para se kjo çështje të procedohet për shqyrtim në seancë plenare.

### **3. Shqyrtimi i mocioneve dhe i kërkesave**

#### **3.1 Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi lidhur me Propozim-vendimin për plotësimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi Propozim-vendimin e Ministrisë së Drejtësisë për plotësimin e anëtarëve në Komisionin për Provimin e Jurisprudencës, nxori këtë

## **P Ë R F U N D I M**

Kërkohe nga Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi që në bashkëpunim dhe konsultim me ministren e Drejtësisë, t'i qartësojë dilemat e parashtruara në rekomandime lidhur me kandidatët e propozuar për plotësimin e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës.

#### **3.2 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për të debatuar në seancë plenare lidhur me identifikimin e mbetjeve mortore dhe zbardhjen e fatit të personave të pagjetur**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

## **P Ë R F U N D I M**

1. Kërkohe nga Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione që në bashkëpunim me Komisionin Qeveritar për Persona të Pagjetur, ta përgatisin një Informatë për identifikimin e mbetjeve mortore dhe zbardhjen e fatit të personave të pagjetur.
2. Informata e kërkuar sipas paragrafit një (1) të këtij përfundimi t'i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, në afatin sa më të shkurtër të mundshëm.

### **3.3 Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit për Integritet Evropian që komisionet parlamentare ta njoftojnë komisionin e lartpërmendur lidhur me veprimet e ndërmarra për përmbushjen e obligimeve në Planin e veprimit të Kuvendit për sfidat e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian, për vitin 2008**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

#### **P Ë R F U N D I M**

Kërkohej nga të gjitha komisionet parlamentare që ta njoftojnë Komisionin për Integritet Evropian për veprimet e ndërmarra në përmbushjen e obligimeve që dalin nga Plani i veprimit të Kuvendit të Kosovës për sfidat e Raportit të Komisionit Evropian për progresin në Kosovë, për vitin 2008.

### **3.4 Shqyrtimi i kërkesës së Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, për emërimin e një anëtari**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi kërkesën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, mori këtë

#### **V E N D I M**

1. Miratohet kërkesa e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës për shpalljen e konkursit për përzgjedhjen e një anëtari të këtij këshilli.
2. Ngarkohet Seksioni i Personelit t'i marrë të gjitha veprimet procedurale dhe të shpall konkursin për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2008/12 për Shërbimin Civil të Kosovës.

### **3.5 Shqyrtimi i kërkesës së gjashtë deputetëve për lejimin e udhëtimit në SHBA**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

#### **V E N D I M**

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetëve: Gani Koci, Haki Shatri, Bojan Stojanović, Myzejene Selmani, Bahri Hyseni dhe Ismet Beqiri në Kongresin e SHBA-ve, prej 26 shtator deri më 3 tetor 2009.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për të lartpërmendurit në paragrafin një (1) të këtij vendimi i mbulon organizatori, ndërsa pjesa shtesë e mëditjeve dhe avansi, në shumën prej 3.000€, përballohet nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë nr. 03-V-094.

### **3.6 Shqyrtimi i kërkesës së tre deputetëve për lejimin e udhëtimit në Asamblenë e NATO-s**

**Kryesia**, pasi diskutoi lidhur me shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

#### **V E N D I M**

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetëve: Xhavit Haliti, Slobodan Petroviq dhe Naim Maloku në Seminarin e 72-të të organizuar nga Asambleja Parlamentare e NATO-s që do të mbahet në Lviv të Ukrainës, prej 15 deri më 18 tetor 2009.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për të lartpërmendurit në paragrafin një (1) të këtij vendimi i mbulon organizatori, ndërsa pjesa shtesë e mëditjeve përballohet nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë nr. 03-V-094.

### **3.7 Shqyrtimi i kërkesës së deputetes Elheme Hetemi për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit në SHBA**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

#### **V E N D I M**

Kryesia nuk mbështeti kërkesën e deputetes Elheme Hetemi për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit për të marrë pjesë në trajnimin në temën: “Tregu dhe mbrojtja e konsumatorit”, që do të mbahet në Madison Wisconsin, SHBA, prej 27. 09. deri më 04. 10. 2009.

### **3.8 Shqyrtimi i kërkesës së deputetit Slobodan Petroviq për kompensimin e mëditjeve për udhëtim zyrtar në Spanjë**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

#### **V E N D I M**

1. Lejohet qëndrimi zyrtar i deputetit Slobodan Petroviq, në Spanjë, prej 13 deri më 15 shtator 2009.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për të lartpërmendurin në paragrafin një (1) të këtij vendimi i ka mbuluar organizatori, ndërsa pjesa shtesë e mëditjeve përballohet nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë nr. 03-V-094.

### **3.9 Shqyrtimi i ftesës së Institutit Demokratik Kombëtar për lejimin e pjesëmarrje në Seminar të një deputeti dhe të tre zyrtarëve të Administratës së Kuvendit**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi ftesën e Institutit Demokratik Kombëtar, mori këtë

## V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetes Safete Hadergjonaj dhe të tre zyrtarëve të Administratës së Kuvendit: Ismet Krasniqi, Isa Neziri, Nexhat Jashari, si dhe të vozitësit Besim Krasniqi, në Mavrovë të Maqedonisë, prej 23 deri më 26 shtator 2009.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit për të lartpërmendurit në paragrafin një (1) të këtij vendimi i mbulon organizatori, ndërsa pjesa shtesë e mëditjeve përballohet nga buxheti i Kuvendit, sipas vendimit të Kryesisë nr. 03-V-094.

### 4. Të ndryshme

#### 4.1 Njoftimi i deputetit Emrush Xhemajli, për dalje nga GP i PDK-së

Kryesia u njoftua me shkresën e deputetit Emrush Xhemajli, që ka dal nga Grupi Parlamentar i PDK-së, dhe në Kuvend do të veprojë si deputet i pavarur.

#### 4.2 Njoftimi lidhur me punimet dhe renovimin e sallës së Kuvendit

Sekretari njoftoi Kryesinë lidhur me dinamikën e zhvillimit të punimeve për renovimin e sallës së seancave plenare të Kuvendit.

4.3 Kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, **Lutfi Haziri**, kërkoi nga Kryesia e Kuvendit që ta procedojë për shqyrtim Projektligjin për qytetin e Prishtinës.

Kryetari tha se Qeveria ende nuk e ka proceduar në Kuvend projektligjin e cekur më lart.

**Kryetari** e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 12:30 minuta.

Kryetari i Kuvendit  
**Jakup KRASNIQI**

---

Hartoi: Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale